

VENDIM
Nr. 311, datë 24.5.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 169, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT TË HYRJES DHE
QËNDRIMIT TË SHTETASVE TË UKRAINËS NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 169, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë”, togfjalëshi “... 1 (një) vit ...” zëvendësohet me “... 2 (dy) vjet ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama